



**Kosova Demokratik Turk Partisi  
( KDTP )**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2018 - 31 Dhjetor 2018**



## Përmbajtja:

Raport i auditorit të Pavarur.....	3-6
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme.....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-14



# Raport i Auditorëve të pavarur

Drejtuar Kryesisë së Kosova Demokrat Turk Partisi

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KDTP”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2018, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin që përfundon me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 10-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2018, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për periudhën, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

### Bazat për opinionin të kualifikuar

- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 5 Toka, objektet dhe pajisjet të pasqyrave financiare përcjellëse, Subjekti Politik ka prezantuar pasuri në vlerë 13,197.00 € me 31 Dhjetor 2018. Subjekti politikë nuk posedon evidencë dhe dokumentacion mbështetës për vlerën 2,947.27 € të aseteve të deklaruara, prandaj ne nuk ishëm në gjendje të vlerësojmë saktësinë, ekzistencën, plotësinë dhe vlerën e aseteve të prezantuara si dhe vlerën e paraqitur si zhvlerësim (31 Dhjetor 2018; 687.00 €).
- Gjate auditimit tonë ne kemi konstatuar se Subjekti Politik, si qiramarrës, për shpenzimet e qirasë në vlerë 12,766.00 € nuk ka ndal tatumim në burim në qira në shumë 1,262.57€, sipas kërkesave ligjore që burojnë nga neni-39 i Ligjit NR:05/L-028 për “Tatumim në të Ardhura Personale.
- Gjate auditimit tonë ne kemi konstatuar që subjekti politikë nga fondet e pranuar ka dhënë ndihma për të tjerët në vlerë 600.00 €, duke vepruar kështu në kundërshtim me Nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-174-tetor 2010, “Për financimin e subjekteve politike” i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet Nr.04/L-058-janar 2012. dhe Ligjin Nr. 04/L-212-gusht 2013.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2. Shpenzimet, të Pasqyrave Financiare përcjellëse, subjekti politik ka deklaruar në kategorinë “Shpenzimet e Transportit” vlerën prej 545.78 € për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2018. Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik dhe ne mungese të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë të sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e Subjektit Politik.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në paragrafin “Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të



Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazë për opinionin tonë.

### **Theksim i çështjes**

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Shpenzimet e shumave të larta për darka nuk kanë të cekura arsyet apo rastin e ndodhjes dhe për to nuk janë praktikuar procedurat e prokurimit;
- Subjekti politike, për shkak të shkeljeve të Ligjeve tatimore në vitet paraprake ka paguar gjoba dhe ndëshkime, kjo mund të konsiderohet si shpenzim joadekuat i parasë publike;
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik e ka definuar me Statut por nuk e ka zbatuar, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës për të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne Neni 17 "Kontrolli i Brendshëm" të Ligjit Nr.03/L-174 "Për financimin e subjekteve politike" i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-212.

### **Përgjegjësia e drejtuesve dhe personave të ngarkuar me qeverisjen e Subjektit Politik për Pasqyrat Financiare**

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me Ligjit Nr. 03/L-174 "Për financimin e subjekteve politike" i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet Nr.04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-212 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e Pasqyrave financiare që nuk përmbajnë mosbarazime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e Pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të shuajë Subjektin Politik ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka asnjë mundësi tjetër.

Personat e ngarkuar me qeverisje, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit Politik.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë arritja e një sigurie të arsyeshme nëse Pasqyrat financiare si tërësi janë pa mosbarazime materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e



auditimit së bashku me opinionin. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një mosbarazim material kur ai ekziston.

Mosbarazimet mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, në mënyrë të arsyeshme, ndikojnë në vendimet e marra ekonomike të përdoruesve, bazuar në këto Pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kemi ushtruar gjykimin profesional dhe kemi ruajtur skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.


Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mosbarazimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një mosbarazimi material si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme etj.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Subjektit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyesh mërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime për aftësinë e Subjektit për të vijuar aktivitetet. Nëse arrijmë në përfundimin të ekzistimit të pasigurisë, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e lëshimit të raportit.

Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme të paparashikueshme mund të bëjnë që Subjekti të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund ta identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Conto sh.p.k

  
Shaban Muharremi  
Auditor ligjor  
6 Tetor 2021



## Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në €	Shuma në €
Toka, objektet dhe pajisjet	5	13,197.00	16,332.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>13,197.00</b>	<b>16,332.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			0.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	23,574.46	14.51
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>23,574.46</b>	<b>14.51</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>36,771.46</b>	<b>16,346.51</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		(15,625.49)	2,016.51
Suficiti / (deficiti) i vitit		39,089.84	(17,642.00)
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>23,464.35</b>	<b>(15,625.49)</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra	5	13,197.00	16,332.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>13,197.00</b>	<b>16,332.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	110.11	15,640.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>110.11</b>	<b>15,640.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>13,307.11</b>	<b>31,972.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>36,771.46</b>	<b>16,346.51</b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2018	2017
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		63,000.00	63,000.00
Të hyrat nga anëtarësia		196.00	1,020.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3		
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			5,900.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyra	5	3,135.00	3,135.00
Të hyrat tjera			
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>66,331.00</b>	<b>73,055.00</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	2,392.56	8,897.78
Shpenzimet e transportit	2	1,545.93	2,046.73
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	553.10	168.40
Shpenzimet e fushatës	2		59,451.93
Blerja e mallrave	2		574.40
Shpenzimet e përgjithshme	2	18,275.32	18,379.26
Shpenzimet e ndryshme	2	4,474.25	1,178.54
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>27,241.16</b>	<b>90,697.04</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>39,089.84</b>	<b>(17,642.04)</b>

## 1. Informata te përgjithshme

Subjekti Politikë: **Kosova Demokratik Turk Partesi**  
Akronimi: **KDTP**  
Selija: **Sheshi i Lidhjes pn, Prizren;**  
Web faqja: **<https://www.kdtp.org/parti/yayinlar/>**  
NF: **600535639**  
E regjistruar: **21.08.2000 nr. regjistrues 114-0800**  
Kryetar : **Mahir Jagcilar**  
Përf.i autorizuar  
financiar: **Sezer Hoti, Prizren,Rifat Ukimeri nr.17 , 045/624-144,  
[hotisezer@outlok.com](mailto:hotisezer@outlok.com);**

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën: NLB.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212, Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.



**Shënimi 2. Shpenzimet**

Shpenzimet	Shpenzimi në €	Pagesa në €	Borxhi i mbetur në €
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	2,160.00	2,160.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	232.56	232.56	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>2,392.56</b>	<b>2,392.56</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	545.78	545.78	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	1,000.15	1,000.15	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>1,545.93</b>	<b>1,545.93</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali			
Ushqimi	453.10	453.10	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	100.00	100.00	0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>553.10</b>	<b>553.10</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			

Kosova Demokrat Turk Partisi

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2018 deri më 31 Dhjetor, 2018

Shpenzimet e fushatës			
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>			
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës			
Pajisjet të vogla			
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>			
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	12,766.00	12,766.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	679.25	679.25	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	1,695.07	1,584.96	110.11
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	3,135.00	3,135.00	0.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime			
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>18,275.32</b>	<b>18,165.21</b>	<b>110.11</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	4,474.25	4,474.25	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>4,474.25</b>	<b>4,474.25</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>27,241.16</b>	<b>27,131.05</b>	<b>110.11</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera në €	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi		Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>						<b>0</b>

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në €
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>0</b>

## Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat	24,500.00		11,800.00	2,450.00	10,250.00
Pajisjet e zyrës	5,318.00		2,361.00	532.00	2,425.00
Pajisjet e teknologjisë informative	1,532.00		857.00	153.00	522.00
Pajisjet tjera					0.00
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>31,350.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,018.00</b>	<b>3,135.00</b>	<b>13,197.00</b>

## Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në €	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në €
Llogari te arketueshme		
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në €	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në €
Paraja në bankë	23,574.46	14.51
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>23,574.46</b>	<b>14.51</b>

Kosova Demokrat Turk Partisi

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2018 deri më 31 Dhjetor, 2018

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në €	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në €
Furnitor vendor		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>0/</b>	<b>0</b>

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në €	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në €
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	110.11	15,640.00
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>110.11</b>	<b>15,640.00</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 €**

Qëlimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në €
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 €</b>					<b>0</b>